



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Genc Zogaj	01.11.2023	09.11.2023	2023/0786

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 12.10.2023, OE “Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0786, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “SAS shpk”- Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera të cilat funksionojnë në kuadër të Spitalit Përgjithshëm Gjilan” me nr. të prokurimit: "220-70001-0731-23-8886-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negociuar, kufizuar, lloji i kontratës: punë, furnizim, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 300,000.00 €. Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0786 i dt: 12.10.2023. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankesës.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

--

Neni 1 - Qëllimi

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 69 - Aftësia teknike dhe/ose Profesionale

Neni 72 - Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë

Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve, i Rregullores Nr.001/2022

Neni 99.2 - Masat Disiplinore për shkeljet e rënda , i Rregullores

Neni 20 & 32 - I Ligjit të Punës Nr.03/L-212

OE ankues ka dorëzuar një dokument voluminoz me analiza, pretendime jo shumë të karta dhe shumë të përgjithësuara, megjithatë eksperti është munduar që të sqarojë këto pretendime sa më mirë dhe të elaborojë ato mbi gjendjet faktike duke u marrë me pretendimet konkrete si në vijim:

Poashtu, ky OE i shpallur fitues ka edhe disa mungesa në dokumentacione dhe disa dokumente të dyshimta dhe të kontestuara në vërtetësinë dhe validitetin e tyre sipas kërkesave në DT tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional , Pozioni 9.1&9.2.

- 1. Mungon Raporti i Vlerësimit të Riskut sic ka kërkuar AK në DT tek kërkesa 7, pika b),**
- Në si OE, gjatë kërkesës për qasje në dokumente, nuk kemi pranuar në email nga AK Raportin e Vlerësimit të Riskut.
- 2. Mungon Deklaratë nga Kompania për Caktimin e Menaxherit sic ka kërkuar AK te kërkesa 6,**
- Në ofertën e OE të rekomanduar nuk është prezantuar deklarata për caktimin e menaxherit të projektit sic kërkohet në DT.
- 3. Tek kërkesa 8, pika b), është kërkuar lista e stafit me të cilën OE planifikon të mbulon kërkesat e DT-së, ndërsa OE ka paraqitur Listën e stafit menaxherial të Kompanisë dhe jo listën me të cilën planifikon të mbulojë pikat e reparteve spitalore, prandaj dhe kjo listë nuk pershtatet me kërkesën në Dosjen e Tenderit,**
- 4. Lista e Kontratave/Referencave nuk është e qartë, sepse nuk kanë datë të fillimit dhe mbarimit, pra nuk është dëshmuar që shërbimet janë të përfunduara sic kërkohet në dosjen e tenderit dhe Kontratat e Sigurimit Fizik nuk përputhen me Kompanitë e shënuara në listë, ku poashtu kontratat e dorëzuara të sigurimit fizik nuk arrijnë vlerën e 600,000.00€, sepse OE i rekomanduar ka deklaruar kontrata të vëzhgimit elektronik dhe jo sigurim fizik sic është kërkuar nga AK dhe Qarkullimi Financiar është kërkuar të jetë minimumi dyfishi i vlerës së parashikur(300.000.00€), pra të jetë 600.000.00€ dhe kontratat e sigurimit fizik nuk arrijnë shumën prej 600.000,00€ dhe kontratat e sigurimit fizik duhet të përputhen me vlerën e kërkuar të Qarkullimit financiar.**
- 5. ISO Standardet 9001:2015 dhe 45001:2018 janë jo-valide, sepse nuk verifikohen në websiten për verifikimin e validitetit apo vërtetësisë së certifikatave.**

KURSE, AK me rastin e eliminimit të OE ankues u ka dhënë këto shpjegime mbi të cilin ata nuk e kanë plotësuar apo dorëzuar analizën financiare si dhe kalkulimet e pagave baze në mënyrë të duhur sic është kërkuar me dosje të tenderit ku është dashur të përdoret edhe kalkulatori zyrtar i

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera të cilat funksionojnë në kuadër të Spitalit Përgjithshëm Gjilan” me numër të prokurimit: “220-70001-0731-23-8886-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN

ATK-se.

Grup OE Besa Security dhe Scorpion 1. Nuk e keni plotësuar Analizen Financiare sipas dosjes së tenderit ku është kërkuar në kërkuar që paga bruto e stafit të jetë jo më e vogël se 350 euro bruto, kurse ju keni shtuar pagaes bruto plus 17.50€ si derivat i këtij lloji është bërë gabimisht llogaritja dhe elementet e tjera të pagës si dhe pushimet vjetore janë llogaritur gabimisht gjë e cila bënë ofertën papërgjegjshme. Sepse paga e një punëtori duhet të vjen nga paga bruto në pagën neto. (Shih shabllonin e ATK-se se si duhet të llogaritet Buro në pagën Net, dhe nga Paga Net në Pagen Bruto <https://www.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/>)

2. Komisioni i vlerësimit ka shpallur fitues OE SAS Shpk i cili është me qmim më të lirë dhe i cili ka dorëzuar Analizen Financiare të kërkesave të AK-se të Specifikuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

KRITERET PËR VLERËSIM

Paga mujore Bruto 350.00€, ku pagës Neto duhet të i shtohet kontributi i punëdhënësit 5%, kontributi i punëtorit 5 % si dhe tatimi mbi paga.

Si do të llogaritet TVSH 18% Sipas Analizes Financiare .

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objektit të Spitalit Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojne ne kuader te Spitalit Përgjithshëm Gjilan” me numër të prokurimit: “220-70001-0731-23-8886-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN

Titulli: Sigurimi fizik i objektit të Spitalit Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojne ne kuader te Spitalit Përgjithshëm Gjilan

Nr. Br.	Tenderuesi	Çmimi Pa TVSH €	Çmimi (me TVSh) €
1.	"SAS" SH.P.K., dalip dalipi, 60 000, GJILAN	276,502.81€	326,273.32€
2.	Grup i Operatorëve Ekonomik Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion; K.S. Besa Security SH.P.K., Rr.Vellezerit Gervalla, 54, Ferizaj	285,092.54€	336,409.20€
3.	"Internat Security Association"SH.P.K., Mustafë Kruja nr.3, 10000, PRISHTINË	265,390.56€	313,160.86€

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

[Spitali i Pergjithshem Gjilan]Shperblen me kontrate per³ aktivitetin e prokurimit : “Sigurimi fizik i objektit të Spitalit Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera te cilat funksionojne ne kuader te Spitalit Përgjithshëm Gjilan ” OE "SAS" SH.P.K., dalip dalipi, 60 000, GJILAN me Çmim 326,273.32€ Operoret Ekonomik i cili ka plotësuar të gjitha kriteret të cilat kane qene në dosjen e tenderit.

Data: 20.09.2023

Emri dhe mbiemri i ZPP:

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion

Pergjigje ne pretendimin ankimor nr.1: Operatori ekonomik ankues pretendon se OE i propozuar per kontrate i mungon:

Mungon Raporti i Vlerësimit të Riskut sic ka kërkuar AK në DT tek kërkesa 7, pika b),

Pergjigje: Gjate ekzaminimit te dokumentacionit eksperti veren se ky pretendim eshte i **bazuar** ngase ne dokumentacionin e dorezuar me rastin e aplikimit per kete procedure prokurimi nje Raport i tille nuk ekziston pervec se ne fajllin nr.8 i emertuar Raporti i autoditereve dhe vleresimi i rriskut pervec raportit te auditorit, vleresimi i rriskut nuk gjendet aty.

SAS SH.P.K.

NUI: 811181792

Raporti i Auditori i Pavarur dhe Pasqyrat Financiare

për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

PRETENDIMI ANKIMOR NR.2 : OE ankues pretendon se:

Mungon Deklaratë nga Kompania për Caktimin e Menaxherit sic ka kërkuar AK tek kërkesa 6, - Në ofertën e OE të rekomanduar nuk është prezantuar deklarata për caktimin e menaxherit të projektit sic kërkohet në DT

6.Operatori ekonomik duhet te caktoj minimum menaxher te projektit me vendim i cili ka per pune min. 3 vite eshte i certifikuar dhe licensuar MPB si menaxher i sigurimit zyrtar ne detyre si sherbimet themelore dhe te specializu. Evidenca 7 .a)Operatori ekonomik duhet

PERGJIGJE: Ne dokumentacionin e derguar ne momentin e aplikimit per kete procedure prokurimi eksperti veren se tek fajlli me nr.17 i emeruar Menaxheri i projektit brenda saj nuk ka vendim me te cilin OE ka caktuar menaxherin e projektit perpos qe ka ngarkuar diplomat dhe certifikatat e punetorit ne fjale (Meral Sadriu Vokshi). Andaj edhe ky pretendim i OE ankues **eshte i bazuar** duke konsideruar faktet dhe dokumentacionin e dorezuar te cilen eksperti e ka pasur ne dispozicion.

PRETENDIMI ANKIMOR 3. Tek kërkesa 8, pika b), është kërkuar lista e stafit me të cilën OE planifikon të mbulon kërkesat e DT-së, ndërsa OE ka paraqitur Listën

e stafit menaxherial të Kompanisë dhe jo listen me të cilën planifikon të mbulojë pikat e reparteve

vlerësimin e riskut. Evidenca 8 .OE duhet të ofrojë deshmi a) Deklarate me shkrim nga operatori ekonomik se do t'i përmbahet në përgjithësi specifikimeve teknike të detyrueshme të paraqitura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe të bashkuara gjitha deshmitë për të gjitha të pikat. b) Operatori ekonomik duhet të prezantojë listen e stafit menaxherial të cilin planifikon të mbulojë kërkesat e dala nga dosja e tenderit dhe nga paramasat. Evidenca 9 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë deshmi se është pajisur me keto a) Certifikata ISO 9001-2 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) b) OHSAS-ISO 45001-2018 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit dhe Sigurisë).|

PERGJIGJE: Pas shqyrtimit të pretendimit dhe dokumentave me kujdes, eksperti konsideron që ky pretendim **nuk është i bazuar** dhe se OE "SAS" shpik ka dërguar një aftësi dhe ashtu siç është kërkuar dokumentacionin e stafit dhe përshkrimet e vendeve të punës të cilat do të punojnë në këtë projekt si dhe certifikatat e sistemit të menaxhimit të sigurisë. Andaj ky pretendim ankimor nr.3 nuk është i bazuar. si psh.

SAS

Security Guard



"SAS SECURITY GUARD" Sh.P.K.
 NUI:811181792
 rr."Dallip Dallipi" nr.30, Gjilan 60000
 Republika e Kosovës
 Mob: +383 43 777 565
 Mob: +383 49 470 420
 E-mail: sas-rks@hotmail.com
 Web: sas-security.eu
 Facebook: Security Guard SAS

Lista e punëtorëve siguria dhe shendetit ne pune

Nr.	Emri Mbiemri	Nr.Personal	Pozita
1	Din Dalipi	1002359894	Drejtor
2	Sevdail Mahmuti	1012059678	Menagjer i punetoreve
3	Hevzi Hyseni	2012414687	Menagjer I sigurimit tehmelor
4	Arsim Idrizi	1170825132	Sigurim themelor/OME
5	Shpetim Ajvazi	1175768765	Operatorë I vëzhgimit Elektronik/Patrollë
6	Vahile Velekinca	1011854512	Operatore e vëzhgimit Elektronik
7	Agron Zeqiri	1235223267	Menagjer I vëzhgimit elektronik/teknik
8	Albion Mahmuti	1231164177	Operatore I vëzhgimit Elektronik

PRETENDIMI ANKIMOR 4: Lista e Kontratave/Referencave nuk është e qartë, sepse nuk kanë datë të fillimit dhe mbarimit, pra nuk është dëshmuar që shërbimet janë të përfunduara sic kërkohet në dosjen e tenderit dhe Kontratat e Sigurimit Fizik nuk përputhen me Kompanitë e shënuara në listë, ku poashtu kontratat e dorëzuara të sigurimit fizik nuk arrijnë vlerën e 600,000.00€, sepse OE i rekomanduar ka deklaruar kontrata të vëzhgimit elektronik dhe jo sigurim fizik sic është kërkuar nga AK dhe Qarkullimi Financiar është kërkuar të jetë minimumi dyfishi i vlerës së parashikur(300.000.00€), pra të jetë 600.000.00€ dhe kontratat e sigurimit fizik nuk arrijnë shumën prej 600.000,00€ dhe kontratat e sigurimit fizik duhet të përputhen me vlerën e kërkuar të Qarkullimit financiar

PERGJIGJE: Tek ky pretendim konsiderojme qe OE ankues ka dalur nga permbajtja e kerkeses se Dosjes se tenderit. Duke sqaruar se ne DT nuk jane kerkuar kontrata dyfish

por qarkullim financiar dyfishi i vlerës së parashikuar të kësaj procedure prokurimi. Andaj, gjatë shqyrtimit të transaksioneve bankare del që të dy Operatorët e plotësojnë këtë kërkesë të DT. Duke konsideruar një vërtetë të vogël tek OE i propozuar për kontratë që në vend të dërgimit të komplet transaksioneve kreditore dhe debitore të bankave do të kishte qenë me mirë ta marrë një deklaratë zyrtare nga banka të vulosur në të cilën shkruhet qarkullimi total i këtyre 3 viteve të fundit ashtu siç ka bërë OE ankues që për shkakë ruajtje privatesis kemi mbuluar shumat financiare. **Andaj ky pretendim sipas ekspertit nuk është i bazuar në faktet e lartepërmendura.**

ProCredit Bank SH.A, Zyra Qendrore – Rr. Xhorxh Bush, Nr.26, 10 000 Prishtinë, Kosovë

VËRTETIM I QARKULLIMIT

Në bazë të kërkesës suaj për të përgaditur një Vërtetim të Qarkullimit në bankë dhe në bazë të të dhënave tona, për klientin SCORPION GROUP SH.P.K., me numër të llogarisë XK051170143330000188, totali i qarkullimit për periudhën 20.03.2020 - 19.03.2023 është :

Emri komercial KOMPANIA E SIGURIMIT FIZIK SCORPION SHPK

Totali i debiteveve : ~~806,833,91X~~

Totali i krediteveve : ~~982,963,48X~~

Ky vërtetim i shërben të njëjtit për nevojat personale dhe nuk mund të përdoret për arsye të tjera.

PRETENEDIMI ANKIMOR nr.5: ISO Standardet 9001:2015 dhe 45001:2018 janë jo-valide, sepse nuk verifikohen në websiten për verifikimin e validitetit apo vertetësisë së certifikatave.

PERGJIGE NE PRETENDIMIN ANKIMOR 5: Ketu eksperti konsideron që çdo gjë është e qartë dhe që ky pretendim ankimor është i pabazuar ngase faktet dhe dokumentacionin tregojnë që OE ka dërguar në dosjen e tyre certifikatat ISO të kërkuara me DT të cilat janë të vulosura dhe kanë një datë lëshimi dhe datë skadence e poashtu edhe në ankesën e OE ankues theksohet se pas rishikimit edhe ata kanë vërtetuar se janë shfaqur këto certifikata në platformën online.

Certificate of Registration

This is to certify that the
Quality Management System
of
SAS SH.P.K
at
DALIP DALIPI PN GJILAN, PO BOX 60000, REPUBLIC OF KOSOVO

has been independently assessed and
is compliant with the requirements of:

ISO 9001:2015

For the following scope of activities:

SECURITY CAMERA MONITORING, ALL TYPES OF ALARM MAINTENANCE AND CONTROL
SYSTEM SERVICES, CLOSE PROTECTION SERVICES, TREASURY SECURITY SERVICES,
FIRE ALARM SYSTEM INSTALLATION AND MAINTENANCE, RISK & SECURITY PLANNING
AND ORGANIZING, STATIC AND PATROLLING SERVICES, SALE AND INSTALLATION OF

Certificate of Registration

This is to certify that the
Occupational Health and Safety Management System
of
SAS SH.P.K
at
DALIP DALIPI PN GJILAN, PO BOX 60000, REPUBLIC OF KOSOVO

has been independently assessed and
is compliant with the requirements of:

ISO 45001:2018

For the following scope of activities:

SECURITY CAMERA MONITORING, ALL TYPES OF ALARM MAINTENANCE
AND CONTROL SYSTEM SERVICES, CLOSE PROTECTION SERVICES, TREASURY
FIRE ALARM SYSTEM INSTALLATION AND MAINTENANCE

Certificate Number: UQ - 2021081363

Validity of this certificate can be verified at www.ukcertifications.org.uk/verify

Date of Certification	13th August 2021
1 st Surveillance Audit Due	12th August 2022
2 nd Surveillance Audit Due	12th August 2023
Certificate Expiry	12th August 2024


Authorised Signatory



This certificate is the property of UK Certification & Inspection Limited and shall be returned immediately on request.
71-75 Shelton Street, Covent Garden, London, WC2H 9JQ, United Kingdom
Website:- www.ukcertifications.org.uk, email:- info@ukcertifications.org.uk
Company No. 11847851

Kurse sa i perkete pretendimit me te cilin eshte eliminuar OE ankues Scorpion dhe Besa Security eksperti ka analizuar kete pretendim dhe japim sqarimet si ne vijim: OE pretendon ne ankesen e tij se: citojme pjese nga ankesa;

Konstatimet e AK-së se ne jemi gabim tek kontributi i punëdhësit shtesë, janë të paqëndrueshme dhe të gabuara sepse sic e shihni më lart, AK ka kërkuar në DT të llogariten Pagat bruto 350€ për punëtorë me të gjitha kontributet dhe tatimet duke përfshirë edhe TVSH, andaj për të sqaruar detajisht, llogaritjet i fillojmë nga paga neto e pagës 350€ bruto sipas kalkulatorit të ATK-së dhe këtë llogaritje kemi sqaruar edhe në sqarimin tonë të datës 19.09.2023 të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues: 1. Paga Neto = 319.10€ 2. Kontributin e Punëtorit 5% =17.50€ 3. Tatimi mbi Paga =13.40€ = 350€ Bruto Pastaj mbi pagën Bruto llogaritet vlera e Kontributit të Punëdhënësit 5% =17.50€ dhe GJITHSEJ PAGA PËR PUNËTOREË ËSHTË 367.50€. - Mund ti referoheni edhe kalkulatorit të ATK-së : <https://www.atk-ks.org/33184-2/> Pra, kërkesa e AK-së në DT ka qenë e qartë se duhet të llogaritet paga bruto 350€ me të gjitha kontributet dhe ajo vlerë prej 17.50€ e Kontributit të Punëdhënësit është shtesë nga paga bruto sic dihet edhe ligjërisht dhe eliminimi jonë në lidhje me këtë pikë , ka kuptimin që AK mohon pagesën e kontributit të punëdhënësit 5% ku përbën shkelje të rëndë të ligjeve të përcaktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës.

PERGJIGJE NE PRETENDIMIN ANKIMOR: Se pari te shohim kerkesen e dosjes se tenderit e cila thote qe:

Paga mujore Burto 350.00€, ku pagës Neto duhet të i shtohet kontributi i punëdhënësit 5%, kontributi i punëtorit 5 % si dhe tatimi mbi paga

Pra, OE ankues sic duket i ka ikur ky detaj ne brendi te teksit ku thot PAGES NETO duhet ti shtohet kontributi dhe tatimi mbi paga dhe jo PAGES BRUTO ashtu sic edhe e ka dorezuar oferten financiare dhe analizen OE ankues "Scorpion". Nga kendveshtrimi ekonomik dhe financiar mbi e cilin edhe eksperti i perket kesaj fushe me kete rast AK ka pasur te drejte ngase OE ankues eshte deshte qe llogaritjen ta beje nga paga baze neto dhe duke shtuar tatimet dhe kontributet te arrij tek paga minimale bruto e kerkuar e cila ka qene 350 euro dhe jo te niset nga 350 e pastaj te shtoj kalkulimet tjera ku edhe me kete rast paga e

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera të cilat funksionojnë në kuadër të Spitalit Përgjithshëm Gjilan” me numër të prokurimit: “220-70001-0731-23-8886-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN

nje punetori i ka dalur 394.03 euro edhe pse eshte e drejte e cdo operatori ta cakton pagen maksimale te punetoreve por ne kete rast eshte deshte qe llogaritja te niset nga paga neto. Pra, shihet qe PAGA NETO e cila ka qene si kerkese baze per nismen e llogaritjes se pages minimale bruto nuk figuron askund ne analizen financiare te derguar nga OE ankues. Andaj edhe ne kete pretendim eksperti konsideron qe AK ka vleresuar drejte kete pike te kerkeses se DT dhe ky pretendim ankimor i OE ankues konsiderohet si jo i bazuar.

	Kalkulimi i pagës së punëtorit	Vlera
	Përshkrimi i aktivitetit/obligimeve	
1	Paga Bruto 350.00€	350.00 €
2	Kontributi i Punëdhënësit 5%	17.50 €
3	Gjithsej paga bruto + Kontributi i Punëdhënësit(1+2)	367.50 €
4	Pushimi vjetor mesatarë në muaj, katër javë - 20 ditë pune (160 orë x 1.99€=318.40€ /12 muaj	26.53 €
5	Gjithsej kosto mujore për 1(një) punëtorë (1+2+3+4)	394.03 €
6	Gjithsej kosto mujore për 19 punëtor (394.03€ x 19 punëtorë)	7,486.57
7	Totali i pagave të 19 punëtorëve për 36 muaj (7,486.57€ x 36 muaj)	269,516.52

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet Vendimi i AK për kualifikimin e Operatorëve Ekonomik dhe rekomandon që lënda të kthehet në rishqyrtim, duke konsideruar dhe propozuar që gjatë rivleresimit të kerkohen sqarime shtese me detaje lidhur me keto pretendime të operatorëve ekonomik.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sigurimi fizik i objektit të Spitali Përgjithshëm Gjilan dhe objekteve tjera të cilat funksionojnë në kuader të Spitalit Përgjithshëm Gjilan” me numër të prokurimit: “220-70001-0731-23-8886-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **SPITALI I PËRGJITHSHËM GJILAN**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion**

Genc Zogaj

